



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ

Data _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHËRBIM

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Mbikqyrje e punimeve në objektin: “Ndërtim Ura Paskuqan 2”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71274000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,759,562.03 (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë tre) Lekë pa tvsh.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kamëz** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 9 (kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- ose
- b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe neni 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm

që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Licensë profesionale** për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë
- **N.P - 4 A** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale,
- **N.P - 5 C** Punime nëntokësore, ura e vepra arti
- **N.P - 11 A** Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S - 6 A** Sinjalistika rrugore jondriçuese
- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin nr.759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e ndryshuar.

Kategoritë e licensave profesionale të kërkuara në fushën e mbikëqyrjes janë në përputhje me kategoritë e licensave të kërkuara për zbatimin e punimeve për të njëjtin objekt, zërave përkatës të preventivit si dhe projektit të zbatimit të punimeve.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të kete te punësuar mesatarisht të paktën 5 (pesë) punonjës për muajin e fundit.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për periudhen e kërkuar, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindese për AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë se shërbimet që kërkohet të kryhen janë për punime të shtrira në territor. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor Drejtues teknik në Licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| - Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder | 1 (një) |

Shënim: Diploma e Inxhinierit të Ndërtimit e lëshuara para vitit akademik 2005, (hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës) mbulojnë profilet Inxhinier Ndërtimi, profili strukturist dhe Inxhinier Ndërtimi, profili gjeoteknik.

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të licensuar, të vërtetuar me Licence profesionale individuale për Mbikqyrje punimesh, kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar

duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin nr. 759, Datë 12.11.2014, Të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik per afatin e kerkuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrushem, operativ i cili do te kryeje sherbimin ne kohe dhe cilesi.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikëqyrjen e punimeve është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë staf mbështetës si më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| - Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| - Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |

Stafi i sipërcituar duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **për muajin e fundit** nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit si dhe duhet të paraqesë dokumentacionin: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV.

Shënim: Për kriterin si më sipër, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentim: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

2.3.6 Operatoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

*** ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente;**

*** ISO 14001:2026 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalente;**

*** ISO 45001-2023, (Sistem i Menaxhimi i sigurisë dhe Shëndetit në punë) ose ekuivalente;**

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe menaxhimin e mjedisit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.*

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të kenë paisjet dhe automjetet si me poshtë:

- Gps 1 copë
- Total station 1 copë

Per pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesi dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si: Faturë tatimore të shitblerjes ose kontratë qiraje të noterizuar.

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.*

Argumentimi : *Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë dhe kanë në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për të realizuar shërbimin. Gps dhe total station duhet për të kontrolluar matjet topografike dhe punën në terren, pasi vepra duhet të ndërtohet duke repektuar kuotat e dhëna nga projektuesi në projekt.*

2.3.8 Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre duhet të referohen **VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.**

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar termat e references, ne te cilat theksohet se jane shprehur qarte kerkesat AK per cilesine e te gjithe sherbimit per realizimin e kontrates.

Po ashtu Njesia pergjegjese thekson se ne specifikimet teknike/termat e references nuk eshte permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar nga komisioni i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe referuar nevojave specifike të vetë AK për objektin e prokurimit.

Grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit i referohet Manualit të tarifave të përcaktuara sipas VKM-së nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mikqyrje dhe kolaudim” duke u mbajtur në konsideratë vlerat minimale dhe maksimale të lejuara sipas manualit të tarifave në këtë VKM, si dhe Manuali i tarifave të përcaktuara sipas V.K.M-së Nr. 216, Datë 13.04.2023 “ Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

NJËSIA E PROKURIMIT: